



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.306/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a në Mitrovicë, ndaj debitorit PTK-Posta me adresë rr. “Afrim Zhitija” në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.1227/19 të datës;18.08.2020, me datën; 21.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

ARPROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a në Mitrovicë, dhe **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.nr.1227/19 të datës;18.08.2020, dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1227/19 të datës 18.08.2020, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.2215/19 të datës; 20.11.2019 sipas urdhërit përmbarimor mbi lejimin e propozimit për përmbarim e P.nr.2215/2019 të dt 20.11.2019 dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e ankimuar ta prish, urdhrin e përmbarimit privat ta aprovoj dhe të pranohet përgjigja në prapësimin dhe ankesa e kreditorit si e bazuar.

Përgjigje në ankesën e kreditorit nuk ka paraqit debitori.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3,

paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit MI..... Përmbartuesi privat Atip Mustafa nga Mitrovica sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.2215/19 të datës 20.11.2019, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të detyrimit në lidhje me marrjen e shërbimit për heqjen e mbeturinave t'i paguaj shumën prej 3,541.65 euro, me kamatën prej 8% nga data e paraqitjes së propozimit deri te pagesa definitive.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 06.12.2019, me pretendimin se ai nuk ka krijuar kurrfar raporti juridik me kreditorin dhe mbi këtë bazë nuk ka kurrfarë obligimesh ndaj tij. Nga AR/AP Extract dt.01.01.2019, 31.12.2019, në të cilat kreditori ka listuar borxhe për datën 01.01.2019 – 31.12.2019 në shumën prej 3,541 euro, nuk mund të kuptohet se cili borxh është pa paguar sepse AR/AP Extract me datat 01.01.2019 -31.12.2019 janë edhe shumë pagesa por nga ato shifra nuk mund të kuptohet se cila faturë konkrete është e papaguar. Në fakt nga faturat kontestuese të listuara në AR/AP Extract nga data 01.01.2019-31.12.2019 në të cilën ka listuar disa borxhe janë të subjektit tjetër juridik përkatësisht subjektit të pavarur juridik Posta e Kosovës sh.a Prishtinë jo PTK tani Telekom i Kosovës sh.a, ku kjo ndërmarrje e re - Posta e Kosovës është pronare e të gjitha objekteve dhe aseteve tjera të paluajtshme. Për të provuar saktë pretendimin e tij debitori prapësimi i bashkëngjiti aktvendimet e Gjykatës Themelore në Mitrovicë CPP.nr.162/16 dt.28.02.2017 dhe CPP/16 dt.nr.29.03.2017, propozon që Gjykata ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor si dhe ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datën 16.12.2019, me arsyetimin se fakt relevant dhe crucial në këtë rast është se propozimi për përmbartim është iniciuar në bazë të dokumentit të besueshëm - faturat apo ekstraktet e kreditorit KRM "Uniteti" sh.a, të cilat i përmbajnë të gjitha të dhënat e sakta lidhur me debitorin duke u bazuar dhe mbështetur në ato ekstrakte si dokumente të besueshme, kreditori kërkon shpenzimet e procedurës përmbartimore në përpilimin e kësaj përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.1227/19 te datës 18.08.2020, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.2215/19 dt.20.11.2019 si dhe ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra duke vendosur në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka arsyetuar se pretendimi i debitorit se të gjitha faturat në bazë të cilave është paraqitur propozimi për

përbarim për shumën e detyrimit prej 3,541.65 euro i përkasin subjektit të pavarur juridik Posta e Kosovës Sh.a në Prishtinë e jo PTK-tani Telekom i Kosovës Sh.a , ku kjo ndërmarrje është pronare e të gjitha objekteve dhe aseteve tjera të paluajtshme, sepse me datën 21.12.2011 në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.16/53 është themeluar Ndërmarrja Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh.a/PK, e ndarë në bazë të Njesisë Postare nga Ndërmarrje Publike e atëhershme Posta dhe Telekomunikacionin i Kosovës dhe e njëjta është e regjistruar në ARBK. Bazuar në këtë del se PTK në cilësinë e debitorit në këtë rast ka legjitimitet pasiv për të qenë palë në procedurë dhe atë duke iu referuar Raportit mbi Ndarjen e Postes nga PTK nr.02-3374/12 dt.02.07.2012 në pikën 3.1 i cili thotë se: *“Për çdo kontest që gjendet në gjykata dhe në vijueshmëri ka qenë, është apo ndërlidhet me Posten e Kosovës, atëherë e njëjta Posta e Kosovës, i merr të gjitha obligimet e zbatimit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore”*. Andaj gjykata bazuar në këto të lartcekura ka shfuqizuar urdhrin përbarimor dhe ka abroguar të gjitha veprimet procedurale konform nenit 43 par.1 të LPP duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1, 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, e lidhur me nenin 29 paragrafi 1, pika 1.3, nenit 71 të LPP-së, ku gjykata nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore dhe kjo ka pasur ndikim në nxjerrjen e vendimit jo të ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, është mbështet në një rekomandim (preferenc) të subjekteve afariste Post Telekomit të Kosovës dhe Posta e Kosovës që daton me datën 26.06.2012. Gjykata e Shkallës së parë ka ngatëruar datat e marrjes së këtij rekomandimi me datën e marrjes së raportit mbi ndarjen afariste të Postës së Telekomit të Kosovës e që është data 02.07.2012 me nr.02-3374/12. Raporti mbi ndarjen e afarizmit është marrë një muaj pas rekomandimit, në dispozitën të cilën është thirrë gjykata e shkallës së parë ku sipas atij rekomandimi thuhet *“Për çdo kontest që gjendet në gjykata dhe në vijueshmëri ka qenë, është apo ndërlidhet me Posten e Kosovës, atëherë e njëjta Posta e Kosovës, i merr të gjitha obligimet e zbatimit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore”*. Ndërsa në raportin e ndarjes së këtyre dy subjekteve thuhet se ndarja e obligimeve dhe detyrimeve që kanë të bëjnë me borxhe, me kërkesa dhe në çështjet që përfshihen në procedura gjyqësore do të vendoset me vonë. Pra dispozita që është cek nga gjykata e shkallës së parë e që rrjedh nga rekomandimi nuk është marrë parasysh por është lënë që të vendoset për këto çështje më vonë sikurse edhe thuhet në pikën 5 nën-pikën b) të raportit mbi ndarjen e Postes nga PTK *“Detyrimet dhe kërkesat ndaj kontesteve- ka një numër të kontesteve disa prej të cilave janë nga vetë punëtorët dhe disa nga palët e treta. Barra eventuale e krijuar si rezultat i këtyre kontesteve ose kërkesat eventuale që mund të dalin nga këto konteste nuk është trajtuar në raportin për ndarje kontabël dhe për këtë arsye është e nevojshme që të gjendet zgjidhje adekuate.”* Përveç kësaj në shkresë të lëndës gjinden ekstrakti me nr.MI...që daton nga 2019 e që nuk kanë të bëjnë fare me periudhën kohore derisa të dy subjektet afariste kanë qenë së bashku, andaj me rastin e ndarjes, këto dy subjekte janë regjistruar në ARBK si

subjekte afariste të pavarura në vitin 2012 . Kështu gjitha obligimet dhe detyrimet dhe borxhet që datojnë për gjatë afarizmit të përbashkët këto dy subjekte afariste i ndajnë në mesë veti sikurse edhe kanë vepruar në bazë të raportit mbi ndarjen të datës 02.07.2012.

Andaj, gjykata e shkallës së parë në riprocedur, me rastin e vendosjes duhet të sqaroi fakti se a kemi të bëjmë me borxhin që është krijuar gjatë afarizmit të përbashkët apo me borxhin që është krijuar pas ndarjes se veprimtarisë apo afarizmit të tyre në bazë të faktit të vërtetuar, se kur është krijuar detyrimi apo borxhi i përmendur në propozimin për përmbarim e tek atëherë të vlerësohet se kush prej këtyre dy subjekteve afariste e bartë kontinuitetin juridik të borxhit në fjalë .

Duke vlerësuar peshën juridike të dy akteve që gjinden në shkresa të lëndës (rapoti mbi ndarjen dhe rekomandimi). Ajo që shihet nga shkresat e lëndës e në bazë të ekstrakti me nr. MI.... të prezentuara rrjedh se shërbimet janë kryer pas ndarjes së subjekteve në fjalë që nga viti 2012, kështu që secila subjekt pas vitit 2012 ka ushtruar veprimtarin dhe afarizmin e vet në mënyrë të pavarur kanë hyrë obligime dhe detyrime. Andaj, gjykata e shkallës së parë me rastin e rivendosjes të dëgjohen palët në procedurë dhe ta vërtetoi se për cilën periudhë kohore kanë të bëjë borxhi i kërkuar para dhe pas ndarjes së këtyre subjekteve. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë duhet të vërtetoi faktin dhe rrethanat se cilit subjekt afarist Posta e Telekomit e Kosovës apo Posta e Kosovës u janë ofruar shërbimet sipas ekstrakti me nr.MI.... të prezentuar në propozimin për përmbarim. Ai subjekt i cili ka shfrytëzuar shërbimet duhet edhe të paguaj nëse ato shërbime janë kryer pas ndarjes së subjekteve në fjalë, respektivisht afarizmit të tyre të pavarur njëra me tjetrën.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (d) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-DHOMA E SHKALLES SË DYTË
K.DH.SH.II nr.306/22, me datë 21.11.2022

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri